



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Bulevardi "Zogu I", Godina 57/2, Nr.18 Tirane

Tel/Fax 04 2226814 ; 2226814

Nr. 312/7 akti

Tiranë 17.06. 2015

V E N D I M

Nr. 60 Datë 17/06/2015

**Mbi përfundimin e procedimit administrativ, filluar me urdhërin e verifikimit  
nr. 312/1 dt. 20.04.2015**

Bazuar në urdhërin e verifikimit nr. 312/1 prot., datë 20.04.2015 "Për verifikimin e aktit nr.700 datë 11.02.2015 "Për mos konfirmim të nëpunësit civil" të punonjësit \*\*\*\*\* me detyrë "Specialist i Sektorit të Teknologjisë së Informacionit" në Drejtorinë e Analizës së Përputhshmërisë dhe Teknologjisë së Informacionit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, sipas kërkesave të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndyshuar me ligjin nr.178/2014 neni 24 dhe 62 i ligjit, VKM nr. 109 dt. 26.2.2014 "Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë", si dhe mbështetur në nenin 13, 14 gërma "a" dhe 34 të Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit" miratuar me Vendimin nr.17 datë 11.03.2015,

V Ë R E J

Marrëdhënia e punës së punonjësit \*\*\*\*\* pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave ka filluar në datën 16.12.2013 në pozicionin e Përgjegjësit të Sektorit të Teknologjisë dhe Informacionit në Drejtorinë e Analizës Strategjike dhe Operacionale pranë DPPPP, dhe ka vijuar në këtë detyrë deri në muajin Dhjetor të vitit 2014, kur për shkak ristrukturimi ka kaluar në pozicionin e specialistit, në Sektorin e Teknologjisë dhe Informacionit.

\*\*\*\*\* ka filluar punë me akt emërimi, duke mos respektuar rregullat e pranimit në shërbimin civil. Fillimi i efekteve të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* e ka gjetur në punë dhe në zbatim të nenit 67, të ligjit në fjalë, ka përfutur statusin e nëpunësit civil në periudhë prove, gjë e cila është materializuar në aktin e deklarimit të statusit të punësimit me nr. 3298/18 datë 30.10.2014 të Departamentit të Administratës Publike.

Gjatë kësaj kohe ai ka kryer kursin e trajnimit të detyrueshëm për nëpunësit civil në periudhë prove organizuar nga ASPA, në periudhën 2-13 shkurt të 2015 duke u vlerësuar në testimin përfundimtarë me 20 pikë nga 28 të mundshme.

Në zbatim të nenit 62, pika 1, i ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* dhe VKM nr. 109 dt. 26.2.2014 *“Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”* sipas formularit të vlerësimit të punës për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të administruar gjatë hetimit administrativ, nëpunësi \*\*\*\*\* për rezultatet e aritura në punë është vlerësuar *“jokënaqëshëm”* nga zyrtari raportues, (nënshkruar edhe nga zyrtari autorizues).

Në këtë formular rezulton se kanë qënë objekt i vlerësimit, si realizimi i objektivave, ashtu dhe sjellja profesionale. Është treguar kujdes që të plotësohen të gjitha ndarjet e formularit, si të dhënat personale, konteksti i punës, objektivat dhe matësit e performancës, sjellja profesionale, etj. Por, vërehet se nënndarja “dh” e formularit ka mbetur pa nënshkruar nga nëpunësi i vlerësuar, i cili duhej të merrte dijeni për vlerësimin duke shënuar në këtë mënyrë momentin e lindjes së të drejtës për paraqitjen e kundërshtimeve të tij, në formë ankese sipas procedurave të parashikuara në ligj.

Kjo, është një mangësi në zbatimin e procedurës së vlerësimit, e cila ka ardhur për shkak të mosmarveshjeve mes eprorit dhe vartësit, pas marjes dijeni nga ky i fundit për vlerësimin *“jokënaqëshëm”*, por nuk është e asaj natyre që çënon përmbajtjen e procesit të vlerësimit. Nënshkrimi i aktit të vlerësimit vjetor nga nëpunësi i vlerësuar, ka lidhje me të drejtën e informimit dhe me ushtrimin e të drejtës së ankimit ndaj aktit të vlerësimit, e drejtë e cila rezulton që të jetë ushtruar nga nëpunësi, i cili pasi është vënë në dijeni ka filluar procesin e kundërshtimit të aktit administrativ, në rrugë ligjore.

Nisur nga gjithë sa më sipër, arrihet në përfundimin se procedura ligjore e ndjekur nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave deri në nxjerrjen e aktit administrativ të vlerësimit, është në përputhje me nenin 24 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i cili parashikon rastet e moskonfirmimit të nëpunësit (pikën 3/c dhe 4), ku parashtrohet e drejta e institucionit të mos konfirmojë nëpunësin në fund të periudhës së provës, në rastin e një vlerësimi negativ.

### **Për këto arsye**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" të ndryshuar, si dhe nenin 34 të Rregullores "Mbi Procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit" të miratuar me Vendimin nr.17 dt.11.03.2015 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil

### **V E N D O S A:**

Përfundimin e procedimit administrativ të Urdhërit nr. 312/1 prot., datë 20.04.2015 "Për verifikimin e aktit nr.700 datë 11.02.2015 "Për mos konfirmim të nëpunësit civil".

Të njoftohen për këtë vendim, Departamenti i Administratës Publike, njësia e burimeve njerëzore të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe shtetasi \*\*\*\*\* .

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**